



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al

Nr. 875/10 Prot.

Tiranë, më 31/12/2016

V E N D I M

Nr. 177, Datë 31/12/2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
"Performanca e detyrimeve të ndërsjella KESH-OST-OSHEE"

Në zbatim të planit vjetor 2016, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI etj.), sipas programit të auditimit Nr. 875/5, datë 28.10.2016, realizoi auditimin me temë "Performanca e detyrimeve të ndërsjella, KESH-OST-OSHEE".

Ky auditim u programua për t'u ushtruar në shoqëritë publike të sektorit energjetik: Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), për periudhën e aktivitetit 2006 – 20.09.2016.

Shoqëria KESH ka në përbërje të saj dy divizione; Divizionin e Gjenerimit, i cili përbëhet nga një sektor dhe tre departamente nën varësi, si dhe Divizionin e Programimit dhe Menaxhimit Strategjik, i cili përbëhet nga tre departamente, me nënndarje në sektorë. KESH me 994 punonjës ka si veprimtari themelore, prodhimin e energjisë elektrike dhe tregtimin e saj në tregun e rregulluar dhe të parregulluar. Ai synon prodhimin e kësaj energjie në mënyrë të sigurt dhe me ndikime minimale në mjedis.

Shoqëria OST ka pesë Drejtori, më konkretisht: Drejtorja e Kabinetit, Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Drejtorja e Prokurimeve, Drejtorja Ekonomike, Drejtorja Ligjore dhe tre departamente: Departamenti i Operimit, Operimit të Tregut, si dhe ai Transmetimit. Shoqëria OST, ka të punësuar 725 punonjës. OST zhvillon sistemin e transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, me planet e zhvillimit të burimeve të reja të energjisë elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkoneksionit me vendet fqinje. OST dispeçeron sistemin elektroenergjetik nëpërmjet menaxhimit të flukseve të energjisë në sistem duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera. Një rol i rëndësishëm është dhe ai i Operatorit të tregut të energjisë elektrike, funksionet e të cilit po zgjerohen

gradualisht me hapat që po hidhen për krijimin e një tregu të lirë të energjisë elektrike në Shqipëri, si dhe integrimin e këtij tregu në tregun rajonal të energjisë elektrike.

Shoqëria OSHEE, ka në varësi tre divizione dhe një departament: Divizionin tregtar që përbëhet nga tre departamente, të zbërthyer në sektorë dhe drejtori përkatëse; Divizionin e Administrimit të Korporatës, i cili ka nën varësi dy departamente dhe një drejtori që zbërthehen në drejtori dhe sektor; Divizionin e Shpërndarjes që ka nën varësi një drejtori dhe katër departamente, të cilat kanë në përbërje të tyre drejtoritë dhe sektorët përkatës, si edhe Departamentin e Zhvillimit të Biznesit, që ka nën varësi dy drejtori dhe tre sektorë kryesor. OSHEE ka në strukturë 6038 punonjës. Misioni i OSHEE, është përmbushja e kërkesave të konsumatorëve për furnizim të pandërprerë dhe cilësor me energji elektrike, nëpërmjet një shërbimi efikas dhe modern.

Sistemi energjetik gjendet prej kohësh në një krizë financiare të trashëguar nga periudhat e mëparshme. Ai ka një mungesë të theksuar efçense, si rezultat i detyrimeve të akumuluar midis shoqërive publike të sektorit dhe kredive të shumta të marra për përballimin e kësaj krize. Kjo mungesë efçense, ndikon në rritjen e kostove të shërbimit dhe rrjedhimisht sjell një impakt negativ mbi treguesit makro ekonomik. Performanca e ulët e shoqërive publike të sektorit energjetik, ka sjellë rritje të nivelit të borxheve të ndërsjella.

Pasqyrat financiare të KESH, OSHEE dhe OST, tregojnë se detyrimi total, deri më datën 20.09.2016, është 80.6 mld lekë.

Megjithëse OSHEE gjatë vitit 2015 dhe 2016 ka rritur nivelin e arkëtimeve, detyrimi i OSHEE ndaj KESH për blerjen e energjisë elektrike është 50.9 mld lekë. Detyrimi OSHEE ndaj KESH për huatë afat-gjata është 11.3 mld lekë. Detyrimi i OSHEE ndaj OST për transmetim energjie, shërbime dhe kredi është 8.2 mld lekë. Detyrimi i OST ndaj KESH për energji, shërbime dhe kredi, është 10.2 mld lekë.

Në bazë të marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim, detyrimi i mbetur i OSHEE ndaj CEZ AS, deri më datë 20.09.2016, është 5.8 mld lekë.

Sistemi energjetik ngelet ende vulnerabël në drejtim të garantimit të cilësisë dhe kostos së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Duke qenë se synimi i operatorëve të sistemit, është mbajtja e një sistemi energjetik efçent dhe të qëndrueshëm, me qëllim garantimin e një shërbimi me cilësi të lartë për qytetarin, shlyerja e detyrimeve të ndërsjella përbën një hap thelbësor në arritjen e këtij qëllimi.

Nëpërmjet këtij auditimi, synohet të analizohet performanca e detyrimeve të ndërsjella KESH-OST-OSHEE, për të dhënë rekomandimet e duhura për fuqizimin e sektorit energjetik me qëllimin që konsumatori final, të përfitojë shërbimin e furnizimit me energji elektrike në cilësinë e duhur dhe me kosto optimale. Fuqizimi i sektorit energjetik, do të sillte uljen e barrës së buxhetit të shtetit për financimin e tij, duke rritur mundësinë për investime në arsim, shëndetësi, infrastrukturë etj. Gjatë këtij auditimi, është shqyrtuar dinamika e detyrimeve të ndërsjella që nga momenti i lindjes, shkaqet dhe aktorët e përfshirë, veprimtaria e vetë subjekteve dhe institucioneve shtetërore, për uljen deri në eliminimin e këtyre detyrimeve.

Në përfundim të punës audituese në terren, iu dërgua projekt-raporti i auditimit subjekteve të audituara, me shkresën Nr. 875/6 Prot., datë 23.11.2016.

Pas përfundimit të periudhës njëmuajore të dërgimit të projekt-raportit, subjekti i audituar OSHEE me shkresën Nr. 30609 Prot., datë 20.12.2016, përgjithësisht konfirmon gjetjet e grupit të auditimit, me sqarime të pjesshme, të cilat nuk prekin konkluzionet e arritura.

OST me shkresën Nr. 7286/1 Prot., datë 21.12.2016, kanë paraqitur observacion mbi projekt – raportin, me disa komente dhe sqarime për çështje të veçanta, duke u dakordësuar me përfundimet e arritura.

Shoqëria KESH nuk ka paraqitur observacion.

Në përfundim, pasi u njoha me raportin përfundimtar të auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit, të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja “c” të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

K O N K L U D O V A:

Shoqëritë publike të sistemit energjetik shqiptar për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë tek konsumatorët fundorë ,operojnë në një treg pjesërisht të liberalizuar, veprojnë në bazë të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe drejtohen në aktivitetin e tyre sipas ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Gjatë veprimtarisë së tyre, këto shoqëri hyjnë në marrëdhënie pune, për pasojë iu lindin të drejta dhe detyrime financiare, të cilat herë për shkaqe administrative dhe më shumë për mangësi menaxhimi, krijojnë detyrime midis tyre, duke ndikuar në dobësimin e sistemit energjetik.

Sistemi energjetik në tërësi ndikon mbi konsumatorin në disa drejtime, pikë së pari në garantimin e furnizimit me energji të pandërprerë dhe së dyti në kostot e drejtpërdrejta nëpërmjet çmimit të energjisë, si dhe kostot e tërthorta nga shpenzimet e buxhetit të shtetit për këtë sektor. Padyshim që sektori i energjisë elektrike është një element i rëndësishëm i sigurisë kombëtare, duke e rritur akoma më shumë nevojën dhe domosdoshmërinë e menaxhimit me efektivitet dhe forcimit financiar, të sektorit energjetik në përgjithësi.

Vendimet e marra deri tani, i kanë shërbyer tejkalimit të situatës emergjente të vështirësive financiare të sektorit energjetik, por nga ana tjetër, ato janë të pamjaftueshme për të konsoliduar qëndrueshmërinë financiare të shoqërive publike të sektorit energjetik, për një periudhë afat-gjatë. Mos respektimi i marrëveshjeve dhe procedurave ligjore, mungesa e investimeve nga ana e kompanive, solli rritjen e nivelit të humbjeve në rrjet, rritjen e kostove të shërbimeve, të cilat së bashku me problemet e mëparshme që shoqëritë kishin, rezultuan në uljen drastike të arkëtimit duke i bërë joefektive ato.

U evidentua se mos respektimi i marrëveshjeve dhe procedurave ligjore nga ana e kompanive, ka sjellë akumulimin dhe rritjen e detyrimeve të ndërsjella, të cilat i kanë venë në vështirësi këto shoqëri për të operuar në kushte normale, për realizimin e misionit të tyre. Nxjerrja e akteve nënligjore, për rregullimin e marrëdhënieve tregtare midis KESH-OST-OSHEE, të pa konsultuara me organet drejtuese të shoqërive, ka shërbyer si pikënisje për akumulimin e detyrimeve të ndërsjella. Keq-administrimi nga niveli drejtues i shoqërive dhe mungesa e profesionalizmit në nivelin e duhur, ka vështirësuar operimin normal të këtyre shoqërive.

Në lidhje me pyetjen kryesore të këtij auditimi,

“A janë efektive procedurat e ndjekura nga qeveria dhe shoqëritë publike të sistemit energjetik, për likuidimin e detyrimeve të ndërsjella midis tyre ?”, u arrit në këtë mesazh:

Masat e marra nga qeveria, mund të konsiderohen të përshtatshme për situatën emergjente të rënduar financiare të shoqërive publike të sektorit energjetik, por nga ana tjetër, ato janë të pamjaftueshme për të konsoliduar qëndrueshmërinë e tregueseve ekonomiko-financiar për sistemin në afat gjatë. Në situatën e tanishme ku ndodhen shoqëritë publike të sektorit të energjisë, nevojitet mbështetja nga qeveria me një kuadër të ri ligjor, i cili duhet të pasqyrojë saktë kërkesat e tyre për të kaluar krizën financiare. Nga ana tjetër, organet drejtuese të këtyre shoqërive, janë në pritje të vendimeve të qeverisë, dhe me praktikatat e tyre të menaxhimit të orientuara në afatshkurtër, nuk kanë arritur deri tani, të rrisin efektivitetin e këtyre shoqërive. Vendimet e marra dhe zbatimi i tyre kryesisht, janë sporadike, dhe nuk janë rezultat i studimeve të mirëfillta të situatës në të cilën gjenden shoqëritë. Rezultatet e parametrave ekonomiko-financiar të këtyre shoqërive, do të rezultonin më të përmirësuara, nëse vendimmarrjet e grupeve të interesit të sektorit energjetik, do të ishin të bashkërenduara dhe të planifikuara dhe do të rezultonin në vendime strategjike.

Nisur nga konkluzionet e mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rezultateve në këtë sektor:

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Performanca e detyrimeve të ndërsjella KESH-OST-OSHEE”, të ushtruar në shoqëritë publike të sektorit energjetik.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

I. Për pyetjen: **A janë ndërmarrë masa dhe procedura efektive për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella në shoqëritë publike të sistemit energjetik?**

Shoqëritë publike të sektorit energjetik, e kanë detyrim ligjor, respektimin e marrëveshjeve mbi të drejtat dhe detyrimet që lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre. Lindja dhe akumulimi i detyrimeve financiare të ndërsjella KESH-OSHE-OST, ka ardhur si rezultat i mos zbatimit të procedurave ligjore, të cilat janë materializuar nëpërmjet marrëveshjeve të pranuar nga këto shoqëri. Marrëdhëniet ndërmjet shoqërive KESH, OST dhe OSHEE janë rregulluar nga marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet këtyre subjekteve dhe konkretisht:

- a) Marrëveshja/Kontrata për Furnizimin me Energji Elektrike ndërmjet KESH - Furnizuesit Publik me Shumice dhe OSHEE - Furnizuesit Publik me Pakice.
- b) Marrëveshja/Kontrata Marrëveshje e Shërbimit të Transmetimit ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE)

Operatori i shpërndarjes nuk i ka respektuar këto marrëveshjet të miratuara nga ERE, kundërshtuar KESH dhe OST, duke ju krijuar këtyre të fundit vështirësi për ushtrimin normal të aktivitetit të tyre.

Këto marrëveshje janë shkëlur konkretisht, për fatura furnizimi energjie elektrike të lëshura nga KESH që nuk njihen/pranohen nga OSHEE; Fatura për kamatëvonesa në pagesa të lëshuara nga KESH që nuk njihen/pranohen nga OSHEE; Mos shlyerje e detyrimeve të OSHEE ndaj KESH për huatë afatgjata; Mos shlyerjen e detyrimit të OSHEE ndaj OST për transmetim energjie etj.

- Mos respektimi i marrëveshjeve dhe procedurave ligjore nga ana e kompanive, ka sjellë akumulimin dhe rritjen e detyrimeve të ndërsjella, të cilat i kanë venë në vështirësi këto shoqëri që të operojnë në kushte normale, për realizimin e misionit të tyre.
- Aktet nënligjore të nxjerra për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet KESH dhe OSSH në periudhën transitore, kanë qenë të pa konsultuara me organet drejtuese të shoqërive përkatëse dhe nuk kanë reflektuar saktë problematiken e vërtetë të këtyre shoqërive, duke shërbyer si pikënisje për akumulimin e detyrimeve të ndërsjella.
- Strategjia e ndjekur nga operatori privat i shpërndarjes CEZ, jo vetëm që nuk e përmirësoi situatën financiare të kompanisë, por përkundrazi solli një përkeqësim të tregueseve financiare dhe një rritje të detyrimeve të ndërsjella, ndërmjet shoqërive të sektorit energjetik, duke vështirësuar operimin normal të këtyre shoqërive.

Për këtë rekomandojmë

- 1. Gjatë vitit 2016 shoqëria OSHEE, duhet të përqendrohet në rritjen e efektivitetit operacional, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe vendosjen e mekanizmave të kontrollit për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare.**

Vazhdimisht

- Për disa nga kreditë OST, nuk ka respektuar skedulën e pagesave sipas marrëveshjeve të bëra. Konkretisht për kredinë EIB Vlora Thermo Power Plant Nr. 22706, në vitin 2010 nuk ka kryer pagesa, megjithëse OST është njoftuar për t'i kryer ato.

Për këtë rekomandojmë:

- 2. OST të respektojë skedulën e pagesave përcaktuar në marrëveshjen e huas.**

Vazhdimisht

- Sektori i kontabilitetit në OST nuk ka bërë kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të gjitha vlerave, në akt-rakordimet e mbajtura.

Për këtë rekomandojmë:

- 3. Titullari i njësisë publike OST, të miratojë dhe të kërkojë zbatimin e veprimtarive të kontrollit, ku përfshihen procedurat për kontabilizimin e plotë, të saktë, dhe në kohë të të gjitha transaksioneve.**

Vazhdimisht

- OST nuk ka marrë masa për arkëtimin në kohë të kostos lokale të transferimit të aseteve.

Për këtë rekomandojmë:

- 4. OST të marrë masa për arkëtimin e kostos lokale të transferimit të aseteve në vlerën 3.152.778 lekë.**

Brenda tremujorit të parë të vitit 2017

- OST nuk ka respektuar marrëveshjen dhe nuk ka marrë masa për regjistrimin në pronësinë e vet të tokës dhe ndërtesës së nënstacionit, që më pas t'ia transferonte OSHEE.

Për këtë rekomandojmë:

- 5. OST të marrë masat e nevojshme për regjistrimin në pronësi të vetë të tokës dhe ndërtesës, me qëllim që të përcaktojë vlerën reale të aseteve.**

Brenda tremujorit të parë 2017

- Në rregulloren e brendshme të OST, lidhur me detyrimet e ndërsjella, nuk parashikohet një procedurë e saktë pune për shlyerjen dhe parandalimin e krijimit të tyre në të ardhmen.

Për këtë rekomandojmë:

- 6. OST me strukturat përkatëse në rregulloren e brendshme të saj, të përcaktojë një procedurë pune për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella dhe parandalimin e krijimit në të ardhmen, e cila të përmbajë tregues sasiorë dhe cilësorë, si dhe afatet për përmbushjen e kësaj procedure.**

Brenda vitit 2017

- OST nuk ka regjistër të riskut, në të cilën të përfshihen dhe çështjet e likuidimit të detyrimeve.

Për këtë rekomandojmë:

- 7. OST me strukturat përkatëse, të marrë masat për hartimin e regjistrit të riskut, duke përfshirë identifikimin e risqeve që pengojnë reduktimin, shlyerjen dhe parandalimin e krijimit në të ardhmen të detyrimeve të ndërsjella.**

Brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2017

- Rezulton se nuk është kryer auditim nga DAB, për detyrimet e ndërsjella që ka OST me shoqëritë e sektorit energjetik.

Për këtë rekomandojmë:

- 8. Drejtoria e Auditit të Brendshëm të marrë masa për kryerjen e auditimeve në vazhdim, mbi detyrimet e ndërsjella që ka OST ndaj shoqërive të sektorit energjetik, për të evidentuar përgjegjësitë dhe parandalimin e krijimit të tyre.**

Vazhdimisht

- Mungon komunikimi dhe bashkëpunimi në nivelin e duhur midis strukturave të brendshme të OST, në lidhje me çështje të detyrimeve në tërësi dhe atyre të ndërsjella në veçanti.

Për këtë rekomandojmë:

- 9. Strukturat e OST, të bashkëpunojnë dhe të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, për të bërë të mundur shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella dhe parandalimin e krijimit të tyre.**

Menjëherë dhe vazhdimisht

- OSHEE, për vitin 2014 dhe 2015 nuk ka kryer asnjë pagesë për detyrimet e kredive, pavarësisht "Njoftimeve për pagesë" të dërguara rregullisht nga ana e KESH.

Gjendja e totale e detyrimeve të Huave, deri në datën 20.09.2016 është 11,37 mld lekë

Për këtë rekomandojmë:

10. OSHEE të marrë masa për të kryer pagesat ndaj KESH sipas Marrëveshjes së Ripagimit të Kredive Afatgjata, me qëllim shmangien dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të ndërsjella.

Vazhdimisht

- Në marrëveshjen e ripagimit të kredive afatgjata konstatohen pasaktësi, për huanë e Projektit “EDCF-ALBKO Babica Project”, pasi OSHEE i ka llogaritur interesat sipas detyrimit në marrëveshje, ndërsa KESH ka evidentuar këto interesa të maturuara sipas skedulit në marrëveshje.

Për këtë rekomandojmë:

11. OSHEE dhe KESH të bëjnë të mundur amendimin e Marrëveshjes së ripagimit të kredive afatgjata, me qëllim eliminimin e kësaj pasaktësie dhe shuarjen e këtij detyrimi.

Brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2017

- Ka mos përputhje në llogarinë mbi huan e marrë nga KESH (principal dhe interesa) në vlerën 146,430,000 lekë midis kontabilitetit të OSHEE dhe KESH, për shkak të kurseve të ndryshme të këmbimit që përdorin.

Për këtë rekomandojmë:

12. OSHEE dhe KESH të marrin masat e nevojshme për të rënë dakord mbi procedurën dhe kohën e llogaritjes së kursit të këmbimit me qëllim që të eliminohen mosraketimet e mësipërme.

Brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2017

- OSHEE nuk ka shlyer detyrimin e njohur dhe të pranuar, për transferimin e asetëve nga KESH në CEZ Shpërndarje, në vlerën 17,410,413 lekë sipas faturave Nr. 5 dhe Nr. 8 datë 31.12.2010.

Për këtë rekomandojmë:

13. OSHEE të marrë masa për të kryer pagesën e transferimit të asetëve nga KESH në CEZ Shpërndarje, në vlerën 17,410,413 lekë, përkatësisht sipas faturave Nr. 5 dhe Nr. 8 datë 31.12.2010.

Brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2017

- KESH nuk ka zbatuar VKM Nr.482, datë 05.06.2015 “Për miratimin e vlerës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet në qarkun e Shkodrës“ në shumën 222,416,775 lekë, duke rënduar jetesën e banorëve të dëmtuar.

Për këtë rekomandojmë:

14. KESH Sha, të ndërmarrë hapat e nevojshëm, duke rakorduar me Ministrinë e Financave për sistemin e shumës 222,416,775 lekë, për të likuiduar dëmet e shkaktuara banorëve të përmbytur në vitin 2015.

Brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2017

- II. Për pyetjen: **Si kanë ndikuar detyrimet e ndërsjella në aktivitetin e secilës prej shoqërive publike të sistemit energjetik?**

Detyrimet e akumuluar ndë vite si dhe keq-administrimi i shoqërive publike të sektorit të energjisë elektrike, kanë ndikuar negativisht në të gjithë sektorin e energjisë dhe rrjedhimisht në aktivitetin ekonomik të secilës shoqëri pjesëmarrëse në këtë sektor. Pasojat kanë qenë të shumta, si rritja e kostove të shërbimit, mungesë e realizimit të investimeve në nivelin e duhur, humbje në energji, uljen e aftësisë paguese të tyre, marrjen e huave për mbulimin e një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve, duke përkeqësuar kështu bilancin e tyre tregtar etj.

- Nga ana e OST, janë bërë propozime për rritjen e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, e cila do të sillte rritjen e tarifës së shpërndarjes nga OSHEE, dhe për pasojë rritjen çmimit të shërbimit të furnizimit me energji për konsumatorin final.

Për këtë rekomandojmë:

15. OST të marrë masat e nevojshme, për të analizuar në mënyrë të detajuar dhe të argumentuar tarifën e transmetimit, duke i shoqëruar ato me efektet që kanë në përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve final.

Vazhdimisht

- OST është karakterizuar nga një nivel i ulët i realizimit të investimeve me fondet e veta, duke evidentuar dobësi në planifikim, mangësi kapacitetesh në procedurat e prokurimit, si dhe mungesë të likuiditeteve për këtë qëllim.

Për këtë rekomandojmë:

16. OST të marrë masat e nevojshme për një planifikim më të mirë të investimeve, të rrisë kapacitete prokuruese, duke bërë të mundur një menaxhim efektiv të fondeve për këtë qëllim.

Vazhdimisht

- OSHEE aktualisht ndodhet në një situatë, në të cilën niveli i financimit nëpërmjet huave është në rritje të konsiderueshme kundrejt kapitalit të vetë

Për këtë rekomandojmë:

17. OSHEE të marrë masa për uljen graduale të nivelit të huamarrjes, si dhe të sigurohet një shpërndarje e tyre në favor të investimeve, për uljen e humbjeve dhe rritjen e arkëtimit, me qëllim përmirësimin e raportit të borxhit ndaj kapitalit.

Vazhdimisht

III. Për pyetjen: **A është performanca e detyrimeve të ndërsjella në linjë me strategjinë e rimëkëmbjes së sektorit energjetik?**

Me gjithë masat e marra nga ana e qeverisë, me një kuadër mbështetës ligjor për të krijuar një sistem energjetik të qëndrueshëm dhe me aftësi likuiduese, për të siguruar furnizim pa ndërprerje të energjisë, rezulton që shoqëritë publike të sektorit energjetik janë ende larg realizimit të këtyre objektivave. Kriza financiare që po kalojnë shoqëritë publike të sektorit energjetik, ka vështirësuar aktivitetin normal të secilës prej tyre, pasi ato kanë marrëdhënie të ndërvarura sipas modelit të tregut të energjisë.

- Detyrimi total KESH, OSHEE dhe OST, deri më datën 20.09.2016, është 80.6 mld lekë. Detyrimi i OSHEE ndaj KESH për blerjen e energjisë elektrike është 50.9 mld lekë. Detyrimi OSHEE ndaj KESH për huatë afat-gjata është 11.3 mld lekë. Detyrimi i OSHEE ndaj OST për transmetim energjie, shërbime dhe kredi është 8.2 mld lekë. Detyrimi i OST ndaj KESH për energji, shërbime dhe kredi, është 10.2 mld lekë. Në bazë të marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim, detyrimi i mbetur i OSHEE ndaj CEZ AS, deri më datë 20.09.2016, është 5.8 mld lekë.

Për këtë rekomandojmë:

18. OSHEE, OST dhe KESH, të respektoj masën e pagesës për detyrimet e ndërsjella, sipas përcaktimit në ligjin nr. 170/2014, "Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ..."

Vazhdimisht

- OSHEE, OST dhe KESH, nuk kanë filluar ende zbatimin e projekteve të përcaktuara në ligjin nr. 170/2014, "Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ...". Gjithashtu evidentohet mungesa e një studimi të saktë, mbi prognozën e ecurisë së shlyerjes së detyrimeve të ndërsjella, veçanërisht në skedulën e pagesave dhe objektivave të vendosura ndaj OSHEE.

Për këtë rekomandojmë:

19. OSHEE, OST dhe KESH, të fillojnë zbatimin e këtyre projekteve, duke i shoqëruar me një studim të mirëfilltë të situatës së tyre ekonomiko-financiare. Gjithashtu OSHEE, OST dhe KESH, të hartojnë një program të saktë për pagesat e detyrimeve të ndërsjella, sipas afateve të caktuara në projektin e rimëkëmbjes.

Brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2017

- Nuk ka gjetur zbatim VKM Nr.126, datë 11.02.2015 "Mbi përcaktimin e shumave të shuarjes me kompensim të detyrimeve ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jo buxhetore që financohen nga buxheti, KESH, OSHEE dhe Ministria e Financave" për shumën 523,781,004 lekë nga OSHEE.

Për këtë rekomandojmë:

20. OSHEE të marrë masat e nevojshme që në bashkëpunim me MZHETS të rakordojë me Ministrinë e Financave për të shuar shumën 523,781,004 lekë, arkëtime të subjekteve buxhetore dhe jobuxhetore, si dhe të bëjë sistemimin e nevojshëm në bilancin e shoqërisë.

Brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2017

- Shoqëritë e sistemit energjetik KESH dhe OSHEE nuk kanë arritur të rakordojnë plotësisht detyrimet e ndërsjella midis tyre, për shkak të qëndrimit të ndryshëm kundrejt faturave të shërbimit në lidhje me gjetjen, njohjen dhe pranimin e tyre.

Për këtë rekomandojmë:

21. OSHEE dhe KESH të marrin masat e nevojshme, që nëpërmjet vendimeve të ministrisë pronare të aksioneve të rakordojnë detyrimet e ndërsjella dhe për diferencën e rezultuar, shoqëritë të kryejnë veprimet e duhura për ta sistemuar në bilancet respektiv.

Brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2017

- Nuk është realizuar brenda tremujorit të parë të vitit 2015, procesi i planifikuar për pagesën e të gjithë shumës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin, që KESH, OSHEE dhe OST, i kanë borxh buxhetit të shtetit

Për këtë rekomandojmë:

22. KESH, OSHEE dhe OST në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Financave, të përgatisë propozimet ligjore për një rishikim të mundshëm të shumës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin, për të sistemuar (net-off) këto detyrime dhe për të pastruar pasqyrat financiare.

Brenda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2017

- Grupi ndërinstytucional për evidentimin dhe adresimin e problematikave, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja në sektorin e energjisë elektrike, nuk ka përgatitur aktet ligjore dhe nënligjore, sipas kërkesave të Urdhrit të Kryeministrit nr.74, datë 27.05.2015.

Për këtë rekomandojmë:

23. KESH dhe OSHEE të kërkojnë nëpërmjet kryetarit të grupit ndërinstytucional, përfaqësuar nga Zëvendësministri i Energjisë dhe Industrisë, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, për të bërë të mundur shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja, në sektorin e energjisë elektrike.

Brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2017

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R